# DËSHMI ARKIVI

**A-433493**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I lidhën duart, e futën në makinë me qese të zezë dhe e hodhën në lumë, detaje nga ekzekutimi i 35-vjeçarit shqiptar në Itali. Zbulohet identiteti |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/09/i-lidhen-duart-e-futen-ne-makine-me-qese-te-zeze-dhe-e-hodhen-ne-lum-detaje-nga-ekzekutimi-i-35-vjecarit-shqiptar-ne-itali-zbulohet-identiteti54/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 9 shtator 2026, 15:32:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 9 shtator 2026, 15:23:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 9 shtator 2026, 15:22:00 UTC → 9 shtator 2026, 15:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1c98cbd23ebc9e1c26885486944336a25b5c9ea878f218e2072a6ca64827d0bd` |
| TEKSTI | `1fb1adc900484d2d195038b61b376311413a5ca9409bffcb32f8d8afc6f8378c` |
| PAMJA | `d338e8763a4f4540d311c3208f97414b1312f21b8c98345c0198c6360a716a3a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bf94d884c8b21c9a7fbf16d88fbe07cbfa4cb7e43caf64df95b1b948c6fb1f6d` |
| E MËPARSHMJA | `7caac718ce6cc263ffadda2af79c0fbbf897f98e4238bdf96c0affc8e342544e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bf94d884c8b21c9a7fbf16d88fbe07cbfa4cb7e43caf64df95b1b948c6fb1f6d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# I lidhën duart, e futën në makinë me qese të zezë dhe e hodhën në lumë, detaje nga ekzekutimi i 35-vjeçarit shqiptar në Itali. Zbulohet identiteti

09/09/2026 17:23

Trupi i pajetë i një shqiptari u gjet në ujërat e lumit Tergola në provincën e Padovës një ditë më parë, ndërsa viktima është identifikuar si Ferdinant Hoti, 35 vjeç.

Hoti u gjet të martën, më 8 shtator, i futur në një qese të zezë në pjesën e pasme të një automjeti tip "Fiat Bravo", i cili kishte përfunduar në ujërat e lumit.

Ekzaminimet e para mjeko-ligjore kanë konfirmuar se 35-vjeçari ishte vrarë me armë zjarri, ndërsa duart i ishin lidhur.

Sipas hetimeve paraprake, dyshohet se bëhet fjalë për një ekzekutim dhe pista kryesore e hetimit lidhet me një larje hesapesh të mundshme të lidhur me trafikun e drogës.

Hetimet po kryhen nga Karabinierët e Njësisë Hetimore të Komandës Provinciale të Padovës, në bashkëpunim me Kompaninë e Cittadella-s. Çështja po koordinohet nga prokurorja publike Claudia Brunino.

Identifikimi i viktimës shënon një moment të rëndësishëm në hetim, i cili tashmë është përqendruar në rindërtimin e lëvizjeve të fundit të Hotit, njohjeve të tij dhe personave me të cilët ai ka pasur kontakte në orët para vdekjes.

Ekzaminimet fillestare mjeko-ligjore kanë konfirmuar natyrën e dhunshme të vdekjes. Dyshohet se Hoti është qëlluar nga afër. Kur trupi i tij përfundoi në lumin Tergola, ai ishte tashmë i vdekur.

Trupi dyshohet se ka qëndruar i zhytur për disa orë. Megjithatë, pritet që autopsia të japë të dhëna më të sakta për kohën e vdekjes dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur vrasja.

Një nga pyetjet kryesore të hetimit lidhet me vendndodhjen ku u hodh automjeti. Hetuesit po përpiqen të zbulojnë nëse personat që e çuan "Fiat Bravo"-n në lumin Tergola e njihnin zonën apo kanë mbërritur aty rastësisht.

Automjeti u fundos pranë një dige, ku niveli i ujit ishte aq i lartë sa e mbuloi pothuajse tërësisht. Megjithatë, zona ka një rrethrrotullim pranë saj, përshkohet nga një arterie e rëndësishme rrugore, është e ndriçuar edhe gjatë natës dhe monitorohet nga disa kamera sigurie.

Pikërisht pamjet e kamerave mund të jenë një prej provave më të rëndësishme për hetimin.

Karabinierët po përpiqen të rindërtojnë itinerarin e ndjekur nga "Fiat Bravo" përpara se të mbërrinte te ura. Sistemet lokale mundësojnë jo vetëm identifikimin e targave, por edhe regjistrimin e automjeteve që kalojnë në pika të ndryshme.

Hetuesit po verifikojnë nëse një automjet tjetër shfaqet në disa prej këtyre pikave të kontrollit, para ose pas kalimit të "Fiat Bravo"-s. Dyshohet se ky automjet mund të ketë ndjekur ose paraprirë makinën dhe mund të jetë përdorur për largimin e autorëve pas hedhjes së saj në kanal.

**Ekzekutohet me armë zjarri 35-vjeçari shqiptar në Itali, autoritetet dyshojnë për "larje hesapesh" nga trafiku i drogës**

Aktualitet

Për hetuesit mbetet e vështirë të besohet se në ngjarje ka qenë i përfshirë vetëm një person. Personi ose personat që e kanë çuar automjetin te ura duhet të kenë pasur gjithashtu një mënyrë për t'u larguar shpejt nga zona.

Pamjet e kamerave të sigurisë të bizneseve lokale, përfshirë ato të një punishteje zdrukthëtarie pranë vendit të ngjarjes, po shqyrtohen gjithashtu.

Pamjet e analizuara deri më tani, të cilat i përkasin natës para se të gjendej automjeti, nuk kanë dhënë ende prova përfundimtare. Për këtë arsye, hetimet vijojnë.

Një tjetër mister lidhet me vetë "Fiat Bravo"-n. Automjeti nuk i përkiste viktimës, por ishte i regjistruar në emër të një shtetasi italian, banues në zonën e Venedikut. Sipas raportimeve, ai u ka deklaruar hetuesve se automjeti nuk ishte vjedhur.

**Top Channel**

Aktualitet »
Tenderi i Unazës dhe vila në Palasë/ SPAK zbardh skemën e dyshuar: Kompania fitoi kontratën, pronari investoi në pronën e Ballukut
09/09 18:00
SPAK njoftim zyrtar, thellohen hetimet ndaj Ballukut/ Sekuestrohet vila në Green Coast, dyshime për korrupsion
09/09 17:50
Dy versione për shpërthimin në zonën e 'Brrylit", ekspertja: Shkëndija mund të jetë shkaktuar nga mungesa e tokëzimit të depozitës
09/09 15:35
Plagosja e dyfishtë në Laprakë, zbardhen rrethanat e ngjarjes, identifikohet autori që sulmoi dy shokët
09/09 15:21
Tjetër tentativë trafikimi droge nga Kanadaja në Shqipëri, kapet në Durrës "Gelato" me vlerë 1.2 milionë euro
09/09 15:02
Analiza/ Filip Çakuli: Republika popullore e protestës
09/09 14:58
Kryesore »
Tenderi i Unazës dhe vila në Palasë/ SPAK zbardh skemën e dyshuar: Kompania fitoi kontratën, pronari investoi në pronën e Ballukut
09/09 18:00
SPAK njoftim zyrtar, thellohen hetimet ndaj Ballukut/ Sekuestrohet vila në Green Coast, dyshime për korrupsion
09/09 17:50
Arti grek në zi, ndahet nga jeta parakohe këngëtari i mirënjohur Giorgos Mazonakis
09/09 16:55
Përplasja në protestë, Iris Luarasi: Aktivistja që më ofendoi u shoqërua për incidentin me makinën e deputetes Ilva Gjuzi
09/09 16:55
E trishtë/ Vuante prej vitesh nga problemet në zemër, ndahet nga jeta në moshën 22-vjeçare "Miss Austria"
09/09 16:43
"Bëhen klipe dasmash", regjisori Shanaj për kinematografinë shqiptare: Filmat e 40 viteve më parë ende mbeten, përçojnë histori. Sot s'ka talent, por padituri e korrupsion
09/09 16:34
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top News- Ngërçi i pagave bllokon gjykatat, gjyqtarët mbledhje urgjente! Bojkot në Tiranë e rrethe
Top News- 'Popull serb ka në Serbi'/ Haxhiu përplaset me deputetin e Listës Serbe
Top Channel/ Rama me drejtuesit politikë në 'Vilën e Kuqe', japin llogari para kryeministrit për…
Top News – 'Pse hesht Rama!'/ Akuzat për trafik armësh, PD: SPAK të hetojë skandalin
Top News- Rregullorja e GJKKO paralizon gjyqet, avokatët bojkotojnë! Shtyhen gjyqe të rëndësishme
Top News – 'Akullore' kanadeze në Durrës/ Kapen në port mbi 100 kilogramë hashash
Kryesore
Përplasja në protestë, Iris Luarasi: Aktivistja që më ofendoi u shoqërua për incidentin me makinën e deputetes Ilva Gjuzi
16:55
Dita e dytë e bojkotit në Gjykatën e Tiranës, administrata vijon protestën për pagat. Avokatët nuk paraqiten në GJKKO
09:53
"Krisje" mes Trump dhe Netanyahut, SHBA lejojnë sanksionet ndaj kolonive izraelite
07:41
Testi PISA 2025, Shqipëria në krye të rajonit, Rama: Dëftesë e jashtëzakonshme, kemi lënë pas edhe disa vende që sot janë në BE
08:38
Mbrëmje kampionësh në Top Channel, sot Napoli-Arsenal. "Studio Champions League" para dhe pas ndeshjes
10:59
Më të lexuarat
Arti grek në zi, ndahet nga jeta parakohe këngëtari i mirënjohur Giorgos Mazonakis
Shpërthim i fuqishëm në një karburant në zonën e Brrylit, mbeten të plagosur punonjësit. Banorët dalin në rrugë të alarmuar
VIDEO/ Tre punonjës të plagosur dhe karburanti i gjithi i shkatërruar, detajet e incidentit që tronditi kryeqytetin. Reagon policia
Ekzekutohet me armë zjarri 35-vjeçari shqiptar në Itali, autoritetet dyshojnë për "larje hesapesh" nga trafiku i drogës
Testi PISA 2025, Shqipëria në krye të rajonit, Rama: Dëftesë e jashtëzakonshme, kemi lënë pas edhe disa vende që sot janë në BE
"Ai është i çmendur dhe shumë i fuqishëm", rrëfimet tronditëse të ish-partnereve të Elon Musk, Daily Mail: Pse ai mund të jetë njeriu më i rrezikshëm në botë
"E godita vetëm një herë me shpullë"/ U la në arrest shtëpie, zbardhet dëshmia e Jozefin Markut në gjykatë: Ishte moment gjaknxehtësie
Dhuna ndaj Eduard Kuçit, gjykata lë në arrest shtëpie Jozefin Markun dhe Kristjan Nikollin
"Cili është problemi me disidentët?"/ Rama i përgjigjet Partisë Demokratike Europiane: A nuk ju vjen turp të mbështesni një sjellje kaq të neveritshme?
"Krisje" mes Trump dhe Netanyahut, SHBA lejojnë sanksionet ndaj kolonive izraelite

- Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi

- Sociale
- Video
- Top News LIVE

- Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

- Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

- Pop News
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

- Programe
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

- Top Channel
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.